



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 869 Prot.

Tiranë, më datë 28.08.2020

VENDIM

Nr. 319, datë 28.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të procedurës së legalizimit për objektin “Godinë banimi 2 kate”, Durrës, me aplikues Z. Ilir Memolla;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elyza MARGARITI

